



**KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që ka  
përfunduar më 31 Dhjetor 2013**

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për menaxhmentin dhe aksionarët e ELSIG SH.A.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të kompanisë së sigurimeve 'ELSIG' (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojnë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

### *Opinion*

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2013 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*BDO KOSOVA L.L.C.*

**KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2013**

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2013 (në Euro)	Më 31 Dhjetor 2012 (në Euro)
<b>ASETET</b>			
Paraja në dorë dhe në bankë	6	763,733	1,304,412
Investimet ne depozita	7	7,473,727	6,539,021
Pjesa e risiguruesit për detyrimet e sigurimeve		203,760	131,342
Kostot e përvetësuara të shtyra	8	1,355,239	1,728,252
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet		764,525	746,521
Asetet e tjera	9	614,810	48,729
Prona dhe pajisjet	10	167,112	155,147
Asetet e paprekshme	11	6,495	8,469
<b>GJITHSEJ ASETET</b>		<b>11,349,401</b>	<b>10,661,893</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Humbjet dhe shpenzimet e korigjimit të humbjes (rezervat teknike)	12	3,077,792	2,955,517
Primet e pa fituara	13	3,169,270	2,765,681
Llogaritë e pagueshme të sigurimit	14	342,395	306,352
Llogaritë e tjera te pagueshme	15	229,456	270,154
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>		<b>6,818,913</b>	<b>6,297,704</b>
<b>KAPITALI AKSIONAR</b>			
Kapitali aksionar	16	4,333,080	4,333,080
Fitimi i akumuluar		197,408	31,108
<b>GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR</b>		<b>4,530,488</b>	<b>4,364,188</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		<b>11,349,401</b>	<b>10,661,892</b>

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 28 Shkurt 2014.

Rexhep Idrizaj

Drejtor Gjeneral

Valon Berisha

Drejtor Financiar